

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Dhjetor 2017

Tiranë, më 23 Janar 2018: Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në vend, në muajin Dhjetor 2017 është 741.685. Krahasuar me Dhjetor 2016, ky tregues rezulton me rritje 8,5 %.

Në vitin 2017, numri shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në vendin tonë është 9.969.322. Krahasuar me vitin 2016, është rritur me 6,9 %.


Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend, në muajin Dhjetor, është 257.474. Krahasuar me Dhjetor 2016, ky numër është rritur me 14,1 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë, në vitin e 2017, është 5.117.700, duke u rritur me 8,1 %, në krahasim me 2016.

Në Dhjetor 2017, hyrjet e shtetasve maqedonas kanë patur rritjen më të madhe, afërsisht me 2 herë, ndërsa uljen më të madhe e kanë patur shtetasit nga Greqia me 17,9 %.

Në vitin 2017, hyrjet nga Polonia kanë patur rritjen më të madhe, me 73,6 % dhe rënie kanë patur vetëm hyrjet nga Kosova, me 19,1 %. (shih tab 2.)

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi, gjatë muajit Dhjetor 2017, janë 673.013, duke shënuar një rritje me 31,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Dhjetor 2017, është 399.137. Krahasuar me Dhjetor 2016, ky numër është rritur 12,7 %.

Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi, gjatë vitit 2017, janë 10.419.480, duke shënuar një rritje me 9,4 %, krahasuar me vitin 2016. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë vitit 2017, është 5.186.100. Krahasuar me vitin 2016, ky numër është rritur 6,9 %.

Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në muajin Dhjetor 2017, në rrugë tokësore zënë peshën më të madhe të hyrjeve gjithsej, me 77,6 %, ndërsa hyrjet në rrugë ajrore zënë 15,5 % dhe detare zënë 6,9 %.

Në vitin 2017, hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në vitin 2017, në rrugë tokësore zënë peshën më të madhe të hyrjeve gjithsej, me 79,3 %, ndërsa hyrjet në rrugë ajrore zënë 13,1 % dhe detare zënë 7,6 %.

Tab.1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Dhjetor-16	Dhjetor-17	Ndryshimi mujor (%)	Janar-Dhjetor 16	Janar-Dhjetor 17	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje gjithsej	683.745	741.685	8,5	9.328.014	9.969.322	6,9
Shqiptarë	458.055	484.211	5,7	4.592.503	4.851.622	5,6
Të Huaj	225.690	257.474	14,1	4.735.511	5.117.700	8,1
Dalje gjithsej	510.845	673.013	31,7	9.521.296	10.419.480	9,4
Shqiptarë	354.030	399.137	12,7	4.852.483	5.186.100	6,9
Të Huaj	156.815	273.876	74,6	4.668.813	5.233.380	12,1

Tab.2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Dhjetor-16	Dhjetor-17	Ndryshim mujor (%)	Janar-Dhjetor 16	Janar-Dhjetor 17	Ndryshim vjetor (%)
Kosovë	64.507	53.837	-16,5	2.157.013	1.745.973	-19,1
Maqedoni	34.808	67.350	93,5	566.761	671.570	18,5
Greqi	35.460	29.105	-17,9	410.876	489.172	19,1
Itali	25.966	28.129	8,3	265.970	363.344	36,6
Angli	6.549	6.514	-0,5	102.628	127.333	24,1
Mali i zi	24.786	27.022	9,0	324.968	380.988	17,2
Poloni	396	671	69,4	66.017	114.582	73,6
SHBA	3.426	3.917	14,3	81.900	97.786	19,4
Gjermani	3.190	5.019	57,3	82.527	121.604	47,4
Zvicër	2.023	2.433	20,3	36.730	54.051	47,2
Të tjera	24.579	33.477	36,2	640.121	951.297	48,6
Gjithsej	225.690	257.474	14,1	4.735.511	5.117.700	8,1

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Dhjetor - 2016	Dhjetor - 2017	Ndryshimi mujor (%)	Janar-Dhjetor 2016	Janar-Dhjetor 2017	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	225.690	257.474	14,1	4.735.511	5.117.700	8,1
I. Personale	219.845	252.240	14,7	4.676.762	5.049.173	8,0
1. Pushime	32.698	53.208	62,7	1.919.160	2.371.503	23,6
2. Vizitë në miq e të afërm	926	991	7,0	18.299	18.766	2,6
3. Vizitë ditore	4.117	7.197	74,8	507.078	292.978	-42,2
4. Trajtim shëndetësor	51	19	-62,7	663	634	-4,4
5. Qëllime fetare	18	29	61,1	1.034	601	-41,9
6. Vizitorë të tjerë	167.425	172.594	3,1	2.071.955	2.182.594	5,3
7. Udhëtarë transit	14.610	18.202	24,6	158.573	182.097	14,8
II. Biznes dhe profesionale	5.845	5.234	-10,5	58.749	68.527	16,6

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Dhjetor - 2016	109.581	56.081	518.083	96.998	27.873	385.974
Dhjetor -20 17	114.992	50.885	575.808	104.855	24.350	543.808
Ndryshimi mujor (%)	4,9	-9,3	11,1	8,1	-12,6	40,9
Janar-Dhjetor 2016	1.098.176	649.842	7.579.996	1.091.005	693.979	7.736.312
Janar-Dhjetor 2017	1.305.953	755.346	7.908.023	1.336.259	780.314	8.302.907
Ndryshimi vjetor (%)	18,9	16,2	4,3	22,5	12,4	7,3

Metodologji

Përkufizime

Vizitorë: Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimit në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.